



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:053852

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05776311

P.nr.79/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me pjesëmarrjen e bashkëpuntorit profesional Ismail Kuçi, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.18/24 të datës 31.05.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit H.L nga fsh.... – Viti dhe të dëmtuarit S.S nga komuna e Vitisë, si dhe mes të pandehurit Sh.I nga fsh....h-Viti dhe të dëmtuarit H.L, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.340/21 të datës 22.03.2021, për shkak të veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, lidhur me të pandehurin H.L dhe veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, lidhur me të pandehurin Sh.I, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.18/24 të datës 31.05.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit H.L nga fsh.... – Viti dhe të dëmtuarit S.S nga komuna e Vitisë, si dhe mes të pandehurit Sh.I nga fsh....h-Viti dhe të dëmtuarit H.L.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.340/21 e datës 22.03.2021 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurve:

1.H.L nga fsh....-Viti, i lindur me datë ..., nga i ati Hazir dhe e ëma H..., e gjinisë Xh..., shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal:..., për shkak të veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

2. Sh.I nga fsh...h-Viti, i lindur me datë ... nga i ati A... dhe e ëma H..., e gjinisë L..., shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.340/21 e datës 22.03.2021, e ka akuzuar të pandehurin, H.L nga fsh....-Viti, për shkak të veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, si dhe të pandehurin, Sh.I nga fsh....-Viti, për shkak të veprës penale, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.05.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.79/21, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 31.05.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.18/24, në mes palëve në procedurë, të pandehurit H.L nga fsh.... – Viti dhe të dëmtuarit S.S nga komuna e Vitisë, si dhe mes të pandehurit Sh.I nga fsh....-Viti dhe të dëmtuarit H.L.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.79/21 datë, 04.06.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.